



Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave të arstistëve interpretues/ekzekutues

AKDIE

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri" Pall. Agimi, shk. 14, hyrja 259 Site : www.akdie.org email: a.k.d.i.e.albania@gmail.com

RAPORT

I AKTIVITETIT TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV AKDIE

PËR VITIN KALENDARIK 2017

Më datë 18.12.2017, me kërkesën e Presidentit të Agjencisë AKDIE, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Agjencisë AKDIE e cila mori në shqyrtim aktivitetin e Agjencisë AKDIE për periudhën janar 2018-dhjetor 2018.

Asambleja e Përgjithshme e artistëve miratoi veprimtarinë administrative të agjencisë „AKDIE“, për vitin 2017, duke e konsideruar atë, në përputhje me interesin më të mirë të Agjencisë AKDIE, të komunitetit të artistëve dhe në përputhje të plotë me ligjin dhe me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Agjencisë AKDIE.

Asambleja e Përgjithshme e artistëve miratoi edhe rezolutën drejtuar institucioneve më të larta të shtetit shqiptar mbi situatën e respektimit të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të dhe në mënyrë specifike atë të artistëve interpretues/ekzekutues dhe AKDIE për shkak të gjendjes katastrofike ku ndodhet agjencia AKDIE.

Gjithashtu Asambleja e Përgjithshme e artistëve miratoi miratoi aktivitetin financiar të kryer përgjatë vitit 2017 të Agjencisë AKDIE duke konkluduar se ka qënë e detyrueshme kalimi i pragut prej 30% për shpenzimet administrative. Sipas kontrollit financiar të kryer, mbi të gjithë zërat e shpenzimeve, nga ku doli se shpenzimet e kryera, kanë qënë në dobi të agjencisë dhe në përputhje me qëllimin e agjencisë, legjislacionin në fuqi dhe vecanarisht me atë tatimor.

Raporti financiar:

- A)** Janë ruajtur me korrektësi përmbushja e të gjitha detyrimeve tatimore. **(20% TVSH+15%TA)**
- B)** Deri më 14 dhjetor 2017, por edhe nën rezervën e mbylljes së vitit financiar dhe të nenit 142 të ligjit nr.35/2016, cka do të thotë se shifrat janë të ndryshueshme, për shkak të rakordimit që do të bëhet me subjektet, të cilat kanë kryer këto pagesa përgjatë vitit 2017.

- C)** Të hyrat financiare në Agjenci për vitin 2017 janë në vlerën 7 218 184 pa TVSH.
- D)** Vlera e shpenzimeve të kryera në bazë të detyrimeve tatimore, TVSH, TAP, Tatim në Burim, Sigurim, taksa etj për vitin 2017 është në shumën 1 111 686 lekë.
- E)** Ruajtjen e rezervës prej 534 819 lekë për qëllime të pagesave të domosdoshme tatimore për fillimin e vitit 2018.
- F)** Humbje nga kursi i këmbimit valuator 13 956 lekë
- G)** Asambleja e Përgjithshme e artistëve miratoi propozimin e Këshillit Ekzekutiv që të shpërndahet tek artistët interpretues ekzekutues shqiptar, sipas legjislacionit në fuqi për OJF, për shkak të anëtarësisë së tyre në AKDIE dhe sipas shpeshtësisë së përdorimit, sipas monitorimeve të kryera nga Kompania e kontraktuar dhe sipas informacioneve të depozituara nga subjektet përdoruese, zbatuese të ligjit nr.35/2016, vlerën prej **2 200 000 lekë, plus vleren prej 180123 e cila ishte shperndarë në fillim të vitit.** Asambleja e Përgjithshme e artistëve miratoi propozimin e Këshillit Ekzekutiv, që këto vlera të shpërndahen vetëm tek artistët shqiptarë anëtarë të saj, për shkak të situatës së jashtëzakonshme financiare ku ndodhet agjencia AKDIE. Ngarkon Drejtorin e Agjencisë AKDIE të njoftojë të gjitha shoqëritë simotra me të cilat AKDIE ka marrëveshje përfaqësimi reciprok për situatën ku ndodhet AKDIE, si dhe të dërgojë listën e anëtarëve të huaj të përdorur tek secili prej tyre, duke njohur detyrimin e AKDIE karshi tyre në vlerën prej 2 500 000 lekë.
- H)** Buxhetimi financiar i Agjencisë AKDIE, sipas ligjit të ri në fuqi, është 30% e vlerave të monetare të shpërndashme, por jo më pak se vlera, sipas parashikimeve të kostove të punës, të domosdoshme, sipas kërkesave të ligjit nr. 35/2016 dhe akteve nënligjore të tij, të miratuara nga Ministria e Kulturës dhe statuti i Agjencisë, duke vazhduar bashkëpunimin kontraktor AKDIE me Zyrën Ligjore „ART“, me Qëndrën „Për të drejtën“ si dhe Kompaninë „VIDASUS“ dhe se shpërblimi i tyre është sipas kontratave të shërbimit dhe marrëveshjeve përkatëse dhe për këtë shkak, nisur nga rrethanat e vështirësive për zbatimin e ligjit, AKDIE, merr përsipër të financojë shërbimet e kontraktuara me Zyrën Ligjore „ART“, me Qëndrën „Për të drejtën“ si dhe Kompaninë „VIDASUS“, në vlerën jo më pak sesa pagat e domosdoshme mujore, që do të duhet të paguheshin për administratën AKDIE duke përllogaritur bazën minimale të shpërblimit neto:

1) <u>Drejtor Ekzekutiv</u>	<u>80 000 lekë.</u>
2) <u>Zyra Juridike</u>	<u>70 000 lekë.</u>
3) <u>Zyra për Marrëdhëniet me institucionet publike dhe ndërkombëtare</u>	<u>60 000 lekë.</u>
4) <u>Zyra e teknologjisë së informacionit</u>	<u>60 000 lekë.</u>
5) <u>Zyra e monitorimit të terrenit</u>	<u>60 000 lekë.</u>
6) <u>Zyra e financës</u>	<u>60 000 lekë.</u>

Gjithashtu nisur nga situatë katastrofike e agjencisë AKDIE, situatë kjo e krijuar për shkak të një viti financiar pothuaj totalisht të djegur, për shkak të paundësisë për të arkëtuar nga ana e Agjencisë, si rrjedhojë e krijimit të Sportelit Unik për të Drejtat e Autorit dhe mosfunksionimit të tij, si edhe për shkak të miratimit tejet të vonuar të tarifave të përdorimit të veprave artistike nga ana e KKDA, artistët anëtarë të agjencisë AKDIE miratuan një rezolutë, drejtuar institucioneve kryesore të shtetit me frymën sa më poshtë:

Artistët, anëtarë të Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve Interpretues dhe Ekzekutues, AKDIE, të vetëdijshëm për përpjekjet e shtetit tonë, për të garantuar me çdo çmim, **hapjen e negociatave të vendit tonë me BE**, sipas kapitujve të MSA, **ku kapitulli 7, neni 73 i MSA-së, përmban rëndësinë e një neni të një marrëveshje ndërkombëtare,**

Me krenarinë e një kontributi specifik dhe të dallueshëm, në arritjen e këtij qëllimi, që përbën një standart të domosdoshëm, për shkak të 17 Kontratave të Përfaqësimit Reciprok, me vendet anëtare të BE, si edhe me Amerikën e Kanadanë,

Me anë të kësaj rezolute, Asambleja e Përgjithshme e Artistëve ka kërkuar vëmëndjen e institucioneve më të larta drejtuese të shtetit shqiptar, nisur nga premisat se:

- *AKDIE, është e vetmja Agjenci e Administrimit Kolektiv të të Drejtave në Republikën e Shqipërisë, që mundëson nenin 73 të MSA, për shkak të 17 kontratave të përfaqësimit reciprok,*
- *AKDIE, është e vetmja Agjenci e Administrimit Kolektiv të të Drejtave në Republikën e Shqipërisë, që punon si Agjente e Mbajtjes së Tatimit në Burim,*

Përsa vijon:

- Viti 2017, ishte një rrënim ekonomik, për të derdhur në buxhetin e shtetit tatimin e përlloritur dhe të njoftuar ndaj Administratës Tatimore dhe Ministrisë së Kulturës, duke mos arkëtuar vlerat monetare, që rrjedhin nga tarifatat e Këshillit Kombëtar të të Drejtës së Autorit, (vendim nr. 3/gusht 2017/fletore zyrtare 200), për shkak të mosorganizimit të Sportelit Unik-nga Agjencia drejtuese e tij, AMP, e përzgjedhur nga Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit, me Vendim nr. 4 datë 10.10.2017, megjithë Udhëzimin e Ministrisë së Kulturës nr. 663 datë 10.10.2017!
- AKDIE, si një organizatë jofitimprurëse specifike, me një veprimtari të vetme dhe ekskluzive, mbledhje dhe shpërndarje të të ardhurave, që vijnë nga përdorimi i të drejtave të artistëve, anëtarë të saj dhe artistëve të huaj, anëtarë të shoqërive simotra të BE dhe Amerikë e Kanada, **e ka të pamundur ekzistencën e saj**, duke e cuar AKDIE, të kalojë pragun ligjor të 30% të të ardhurave të hyra, të ardhura **(vlera 8 661 821 lekë me TVSH)** që duhet të kthehen mbrapsht, tek përdoruesit, që kanë kryer pagesa të ndryshme nga Tarifatat e përcaktuara nga KKDA, (neni 142 i ligjit nr. 35/2016), për shkak të tarifës së dalë nga KKDA, më datë 04 gusht 2017.

Asambleja e Përgjithshme e Artistëve, në mbledhjen e saj u shpreh edhe nëprmet rezolutës së miratuar se protestojnë fuqishëm me qëllim që institucionet të përmbushin detyrimin e tyre ligjor, për t'ia arritur qëllimit të arkëtimit të vlerës tarifore të KKDA-së, tek të paktën 13 000 subjektet tatimpagues, të njoftuar nga Administrata Tatimore, **në vlerën 201 838 084 lekë me TVSH+Tatim në Burim.**

- **Asambleja e Përgjithshme e artistëve u ka kërkuar drejtueseve të institucioneve të shtetit,** për të marrë masa të menjëhershme, **për ndërprerjen e situatës së paligjshmërisë së mosveprimit të Sportelit Unik -SUADA,** për shkak të **(1)** cëimin e buxhetit të shtetit, për mungesën e tatimit në burim, që mbahet nga AKDIE dhe të Tatimit të Vlerës së Shtuar, **(2)** të vlerave montare-principal që i mungojnë AKDIE dhe jo vetëm asaj, por edhe Agjencive të tjera, përfshi **(3)** cënimin e të drejtave të prodhuesit të veprave audiovizuale dhe kinematografike, (*RTSH, Top-Channel, Klan, Vizion Plus, Digitalb, Tring, megjithëse këto subjekte tatimpagues, kanë detyrime themelore dhe serioze, sepse nuk paguajnë kurrë ndaj AKDIE dhe jo vetëm*), duke u lutur të merrni dijeni të plotë për shkaqet ligjore, në përzgjedhjen e sportelit unik, përzgjedhje e cila, deri më tani, rezulton katastrofike dhe Vendimi nr. 3/2017, i KKDA rezulton në kapërcim të plotë me frymën e ligjit si edhe në kundërshtim me kriteret e neit 138 të Ligjit nr.35/2016.
- **Asambleja e Përgjithshme e artistëve ka kërkuar** për të sensibilizuar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të ndërhyrë, për arkëtimin e shumës së njoftuar nga Administrata tatimore, në vlerën **201 838 084 lekë, si veprim procedural tatimor, vlerë e cila është dëm i shkaktuar AKDIE dhe është borxh i akumuluar karshi saj nga subjektet debitorë.**

Raporti i subjekteve përdoruese dhe të drejtave të përdorura:

1. SUBJEKTET PËRDORUESE:

a/ rezultojnë subjekte përdoruese rreth 80 000 subjekte

b/janë njoftuar nga AKDIE dhe DPT dhe DRT 13 000 **subjekte me vlerën përkatëse të detyrimit të papaguar 201 838 084 lekë**

c/ kanë përmbushur detyrimin vetëm 61 subjekte ose 0.07 % e subjekteve me vlerën 7 218 184 pa tvsh

2. TË DREJTAT TË ARKËTUESHME:

a/e drejta e transmetimit të fonogramit/videogramit të regjistruar dhe në qarkullim tregtar

b/ e drejta e ritransmetimit kabllor

c/e drejta e komunikimit në publik të veprave të regjistruara paraprakisht në mbajtëse zëri dhe figure

3. NUMRI I PLOTË I ARTISTËVE NË PËRDORIM DHE RAPORTI I ARTISTËVE TË SHPËRBLYER:



a/ në total janë të përdorur dhe të shpërblyer 14 518 artistë nga të cilët 129 janë shqiptarë



b/1 197 artistë të shpërblyer nga veprat audiovizuale nga të cilët 51 janë shqiptarë

c/13 321 artistë të shpërblyer nga veprat muzikore

d/4751 artistë janë artistë kryesorë të muzikës si këngëtarë

e/8571 artistë janë artistë dytësorë të muzikës si instrumentistë apo korristë





DREJTOR EKZEKUTIV

NAIM ALIAJ